



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:287873

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05419515

C.nr.9578/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.R, V.V, Sh. S, H.R, Ç.Z, dhe B.K, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Fis Murati, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, lidhur me kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022, në lartësi të objektit të kontestit 13,488.62 Euro, jashtë seancës, me datë 06.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tersi e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.R, V.V, Sh. S, H.R, Ç.Z, dhe B.K, ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, që paditësve në emër të kompensimit të pagës së trembëdhjetë, t'ua paguaj secilit paditës shumat si vijon:
- a) Paditësit F.R, në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitin 2020, shumën prej 692.98 Euro, për fundvitin 2021 shumën prej 564.58 Euro, si dhe për fund vitin 2022 shumën prej 750.73 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 2,008.29€.
 - b) Paditësit V.V në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitin 2019, shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2021 shumën prej 610.53 Euro, si dhe për fund vitin 2022 shumën prej 581.58 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 1,694.61€.
 - c) Paditësit Sh.S në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t'ia paguaj për çdo vit shumën prej 625.69€, apo shumën e përgjithshme prej 2,502.76 €.
 - d) Paditësit H,R në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t'ia paguaj për çdo vit shumën prej 625.69€, apo shumën e përgjithshme prej 2,502.76 €.

- e) Paditësit Ç.Z në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitin 2019, shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2020 shumën prej 715.64 Euro, si dhe për fund vitin 2021 shumën prej 533.86 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 1,752.00€.
- f) Paditëses B.K në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitin 2019 shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2020 shumën prej 788.21 Euro, për fundvitin 2021 shumën prej 589.20 Euro, si dhe për fundvitin 2022 shumën prej 1,148.29 Euro, apo në total shumën prej 3,028.20 Euro.
- II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, që paditësve F.R, V.V, Sh. S, H.R, Ç.Z, dhe B.K, t'ua paguaj shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila do të llogaritet duke filluar nga data ushtrimit të padisë datë 21.12.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 724.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m

Paditësit, në këtë gjykatë me datë 21.12.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shujtës, e cila padi është precizuar sipas parashtresës së datës 01.02.2024, ku si objekt i vetëm i kontestit ka mbetur kompensimi i pagave të trembëdhjeta për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Në padi dhe precizimin e saj paditësit kanë theksuar se janë në marrëdhënie tek e paditura. Kanë theksuar se në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të UA 02/2018, parasheh se personelit të policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore të vitit. Ka shtuar se deri në ditën e ushtrimit të padisë e paditura nuk u ka paguar kompensimin e tillë paditësve.

Me parashtresën e datës 01.02.2024, i autorizuari i paditësve kanë bërë rregullimin e padisë në aspekt objektiv, duke i propozuar gjykatës që të aprovoj në tërsi kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyrohet e paditura që paditësit F.R , në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia paguaj për fundvitin 2020, shumën prej 692.98 Euro, për fundvitin 2021 shumën prej 564.58 Euro, si dhe për fund vitin 2022 shumën prej 750.73 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 2,008.29€, paditësit V.V në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia paguaj për fundvitin 2019, shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2021 shumën prej 610.53 Euro, si dhe për fund vitin 2022 shumën prej 581.58 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 1,694.61€, paditësit Sh.S në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia për fundvitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t'ia paguaj për çdo vit shumën prej 625.69€, apo shumën e përgjithshme prej 2,502.76 €, paditësit H.R në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia për fundvitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t'ia paguaj për çdo vit shumën prej 625.69€, apo shumën e përgjithshme prej 2,502.76 €, paditësit Ç.Z në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia për fundvitin 2019, shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2020 shumën prej 715.64 Euro, si dhe për fund vitin

2021 shumën prej 589.20 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 1,752.00€, dhe paditëses B.Kk në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë t'ia për fundvitin 2019, shumën prej 502.50 Euro, për fundvitin 2020 shumën prej 788.21 Euro, për fund vitin 2021 shumën prej 589.20 Euro, si dhe për fund vitin 2022 shumën prej 1,148.29 Euro, apo në total shumën e përgjithshme prej 3,028.20€, të gjitha këto me kamatë ligjore 8% vjetore, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive të detyrimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura ka parashtruar përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Në përgjigje në padi e paditura ka theksuar se nuk është kontestuese fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimet e punësimit të lëshuar nga e paditura. Ka theksuar se e kundërshton shumën e kërkuar nga paditësit në emër të pagës së fund vitit dhe ushqimit gjatë punës, me arsyetimin se nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mjeteve financiare, përveç shpërblimit jubilar. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 nuk ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së fundvitit dhe ushqimit gjatë punës. Më tej ka shtuar se kërkesa e paditësve vlen vetëm brenda mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar si detyrim i tani të paditurës. Ka theksuar se e paditura si detyrim të vetmin ndaj paditësve ka përmbushjen e kontratës së punës e cila konsiderohet ligj për palët. Andaj edhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata plotësimin e padisë të bërë me datën 01.02.2024 nga i autorizuari i paditësve, ia ka drëzuar të paditurës me datën 26.02.2024, mirëpo e njëjta deri në marrjen e këtij aktgjykimi nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje lidhur me plotësimin në fjalë.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestuese është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritore jashtë seance.

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Ndërsa, me nenin 4 paragrafi 2 i të njëjtit ligj, përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve*

procedurale te shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Këtë Gjykata e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit për paditësin e parë F.R , me nr. të referencës 07/1-01SAP-P/0610, i datës 22.01.2024, për paditësin e dytë V.V nga vërtetimi me nr. të referencës 07/1-01SAP-P/0608, i datës 22.01.2024, për paditësin e tretë Sh.S nga vërtetimi me nr. referencës DDK-05/0583/2023, i datës 21.08.2023, për paditësin e katërt H.R nga vërtetimi me nr. references 05/3-01SRR/0218, i datës 24.01.2024, për paditësinë e pestë Ç.Z nga vërtetimi me nr. referencës 07/1-01SAP-P/0609, i datës 22.01.2024, si dhe për paditësen e gjashtë B.K nga vërtetimi me nr. referencës 05/3-01/SRR-3991, i datës 30.10.2023.

Po ashtu nuk ishin kontestuese pagat mujore të cilat i realizojnë paditësit tek e paditura. Kështu nga lista e pagave dhe vërtetimet të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, vërtetohet se:

- paditësi i parë F.R , në muajin dhjetor të vitit 2020 ka realizuar pagë në shumën prej 692.92 Euro, në muajin dhjetor 2021 ka realizuar pagë në shumën prej 564.58 Euro, kurse në muajin dhejtor 2022 ka realizuar pagë mujore në shumën prej 750.73 Euro,
- paditësi i dytë V.V , në muajin dhjetor 2019 ka realizuar pagë mujore në shumën prej 502.50 Euro, në muajin dhjetor 2021 ka realizuar pagë në shumën prej 610.53 Euro, kurse në muajin dhejtor 2022 ka realizuar pagë mujore në shumën prej 581.58 Euro,
- paditësi i tretë Sh.S dhe paditësi i katërtë H.R , kanë realizuar pagë mujore në shumën prej nga 625.69 Euro,
- paditësi i pestë Ç.Z në muajin dhjetor 2019 ka realizuar pagë mujore në shumën prej 502.50 Euro, në muajin dhjetor 2020 ka realizuar pagë në shumën prej 715.64 Euro, kurse në muajin dhjetor 2021 ka realizuar pagë në shumën prej 533.86, si dhe
- paditësja e gjashtë B.K në muajin dhjetor 2019 ka realizuar pagë mujore në shumën prej 502.50 Euro, në muajin dhjetor 2020 ka realizuar pagë në shumën prej 788.21 Euro, në muajin dhjetor 2021 ka realizuar pagë në shumën prej 589.20, kurse në muajin dhjetor 2022 pagën në shumën prej 1,148.29 Euro.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së është paraparë së “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me lartësinë e pagës, gjykata ia fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.*

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, dhe dispozitat e Udhëzimit

Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhënine e punës në Policinë e Kosovës, për kërkesat e aprovuara të paditësve, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13, për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.*

Nga interpretimi i dispozitave të lart cekura të Udhëzimeve Administrative të nxjerr nga vet e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e bazuar, kjo për faktin se paditësit gëzojnë të drejtën që në fund të një viti kalendarik të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës si dhe nëse nuk u është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Duke u bazuar në formularët e vlerësimit të performancës që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se paditësit kanë pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtëve nuk u është shqiptuar ndonjë masë disiplinore gjatë viteve në të cilat kërkohen pagat e fundvitit. Për më tepër e paditura me anë të përgjigjes në padi nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësve.

Gjykata vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave së cekur më lartë, që t’ia kompensoj paditësve, pagat e trembëdhjeta, për fund vitet e specifikuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në këtë rast paditësit e kanë cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD -së), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.* Prandaj, gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ua kompensoj shumën e gjykuar, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se Gjykata vlerëson se e paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimet Administrative, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të të

paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenit 382 të LMD-së, sipas të cilës dispozitë është paraparë se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, dhe si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e paraqitjes së padisë në Gjykatë, datë 21.12.2021.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 624.00.00€ (përpilimi i parashtrësive në procedurë civile për gjashtë paditës, në kontestet me vlerë mbi 10,000.00 € sipas tarifës së Odës së Avokatëve) dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 100.00 €, apo në shumën e përgjithshme 724.00 €.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -
C.nr.9578/21, datë 06.03.2024.

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.